



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO			
AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE			
REGULATIVNI AUTORITET ŽELEZNICA			
RAILWAY REGULATORY AUTHORITY			
DEP/SEK. DEP/SEK: DEP/SEK:	01	NR PROT BR.PROT NR.PROT:	370
NUMRI I FAQEVË BROJ STRANA NR OF PAGES	12	DD.MM.VVVV: DD.MM.GGGG: DD.MM.YYYY:	12/12/2018
PRISHTINË / A			

Në mbështetje të nenit 38 (2), nenit 101 (3), nenit 102 (4) të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës, Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton:

Rregullore Nr. 07/2018

Për Adoptimin e një Metode të Përbashkët të Sigurisë për vlerësimin e arritjës së Caqeve të Sigurisë

Rr. Rrustem Statovci nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tel:+381 38 22 00 40
Fax:+381 38 22 33 40
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i një metodë të përbashkët të sigurisë që do të përdoret në Kosovë për llogaritjen dhe vlerësimin e arritjes së caqeve të përbashkëta të sigurisë (CPS), në zbatim të Nenit 6 (1) të Direktivës 2004/49 / EC.
2. Në përputhje me Direktivën 2004/49 / EC, caqet e përbashkëta të sigurisë (CPS) dhe metodat e përbashkëta të sigurisë (MPS) duhet të futen gradualisht për të siguruar që një nivel i lartë i sigurisë është ruajtur dhe kur dhe ku është e nevojshme dhe e mundur, është përmirësuar.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen për të gjithë menaxherët e infrastrukturës dhe operatorët hekurudhor të cilët operojnë ligjërisht brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Kjo rregullore nuk do të zbatohet për:

- a) metro, tramvajet dhe trenat e lehtë;
- b) rrjetet që janë funksionalisht të ndara nga pjesa tjetër e sistemit hekurudhor dhe të destinuara vetëm për ofrimin e shërbimeve të transportit lokal, urbanë ose ndërurban, si dhe ndërmarrjet hekurudhore që operojnë vetëm në këto rrjete;
- c) infrastrukturë hekurudhore në pronësi private që ekziston vetëm për përdorim nga pronari i infrastrukturës për transport të mallrave për nevoja të veta;
- d) mjetet lëvizëse të trashëgimisë kulturore që operojnë në rrjetin kombëtar me kusht që ato të jenë në përputhje me rregullat dhe rregulloret kombëtare të sigurisë me qëllim sigurimin e qarkullimit të sigurt të mjeteve të tilla lëvizëse;
- e) mjetet e trashëgimisë historike, muze dhe hekurudhat turistike që veprojnë në rrjetin e vet.

Neni 3 Definicionet

Për qëllimet e kësaj rregullore, do të zbatohen përkufizimet e Direktivës 2004/49 / EC dhe Rregullores (EC) Nr. 91/2003.

Përveç kësaj, përkufizimet e mëposhtme do të zbatohen:

- a) 'vlera kombëtare e referencës (National Reference Value-NRV)' nënkupton një masë reference që tregon nivelin maksimal të tolerueshëm për një kategori të rrezikut në hekurudhë;

- b) 'kategoria e rrezikut' nënkupton një nga kategoritë e rrezikut në hekurudhave e përcaktuar në nenin 7 (4) (a) dhe (b) të Direktivës 2004/49 / EC;
- c) 'plani për përmirësimin e sigurisë' nënkupton një plan për zbatimin e strukturës organizative, përgjegjësi, procedurave, aktiviteteve, aftësi dhe burimeve të nevojshme për të zvogëluar rrezikun për një ose më shumë kategori rreziku;
- d) 'viktima dhe lëndime serioze (Fatalities and Weighted Serious Injuries- FWSI)' nënkupton një matje të pasojave të aksidenteve të rëndësishme që kombinojnë viktima dhe lëndime të rënda, ku një dëmtim serioz konsiderohet statistikisht i barabartë me 0,1 viktima;
- e) 'përdoruesit e kalimit në nivel' nënkupton të gjithë personat që përdorin një kalim në nivel, për të kaluar vijën hekurudhore me çdo mjet transporti ose në këmbë;
- f) 'stafi' ose 'punonjësit duke përfshirë stafin e kontraktorëve' nënkupton çdo person, i punësuar i cili direkt ose indirekt është në lidhje me një hekurudhë dhe është në punë në momentin e aksidentit; ai përfshin ekuipazhin e trenit dhe personat që trajtojnë mjetet e transportit hekurudhor dhe instalimet e infrastrukturës;
- g) 'personat e paautorizuar në objektet hekurudhore' do të thotë çdo person i pranishëm në mjediset hekurudhore ku prania e tillë është e ndaluar, me përjashtim të përdoruesve të kalimit në nivel;
- h) 'të tjerë (palë të treta)' do të thotë të gjithë personat që nuk janë të definuar si 'udhëtar', 'punonjës duke përfshirë stafin e kontraktorëve', 'përdorues të kalimit në nivel' ose 'persona të paautorizuar në objektet hekurudhore';
- i) 'rreziku për shoqërinë në tërësi' nënkupton rrezikun kolektiv për të gjitha kategoritë e personave të renditur në Nenin 7 (4) (a) të Direktivës 2004/49 / EC;
- j) 'tren-km të pasagjerëve' nënkupton njësinë e masës që përfaqëson lëvizjen e një treni pasagjerësh mbi një kilometër; merret parasysh vetëm distanca në territorin kombëtar të vendit raportues;
- k) 'binarë-km' do të thotë gjatësia e matur në kilometra të rrjetit hekurudhor ku traseja (shina) e një linje hekurudhore të shumëfishtë duhet të numërohet.

Neni 4

Metodologjitë për të llogaritur NVR-të dhe CPS dhe për të vlerësimi i tyre

1. Metodologjia e përshkruar në Shtojcë do të zbatohet për llogaritjen dhe vlerësimin e të arriturave të NRV-ve dhe CPS.
2. Agjencia (ERA) i propozon Komisionit NRV-të e llogaritura në përputhje me seksionin 2.1 të Shtojcës dhe CPS që rrjedhin nga NRV-të, në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në seksionin 2.2 të Shtojcës. Pas miratimit të NRV dhe CPS nga Komisioni, Agjencia vlerëson arritjen e tyre nga Shtetet Anëtare në përputhje me kapitullin 3 të Shtojcës.
3. Vlerësimi i kostove dhe përfitimeve të vlerësuar të CPS të përmendura në Nenin 7 (3) të Direktivës 2004/49 / EC do të bëhet në ato vende ku NRV-të për secilën nga kategoritë e rrezikut janë më të larta sesa ato korresponduese CPS.

Neni 5 Veprimet e zbatimit

Në përputhje me rezultatet e ndryshme përfundimtare të vlerësimit të arritjeve, të referuara në pikën 3.1.5 të Shtojcës, duhet të ndërmerren veprimet e mëposhtme zbatuese:

- a) në rast të 'përkeqësimit të mundshëm të performancës së sigurisë': Shteti (Kosova) i dërgon Komisionit një raport që shpjegon shkaqet e mundshme të rezultateve të fituara;
- b) në rast të 'përkeqësimit të mundshëm të performancës së sigurisë': Shteti (Kosova) do t'i dërgon Komisionit një raport që shpjegon shkaqet e mundshme të rezultateve të marra dhe paraqet, nëse është e përshtatshme, një plan për rritjen e sigurisë.

Për të vlerësuar çdo informacion dhe dëshmi të ofruar nga Kosova në përputhje me procesin e përmendur në pikat (a) dhe (b), Komisioni mund t'i kërkojë Agjencisë (ERA-s) të japë mendime teknike.

Neni 6 Transpozimi

Kjo rregullore transponon vendimin e BE-së me Nr. 2009/460/EU.

Neni 7 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Arsim Berisha,
Kryesues i Bordit
Prishtinë: 27.12.2018

SHTOJCË

1. **Burimet statistikore dhe njësitë matëse për llogaritjen e NRV-së dhe CPS**
 - 1.1. Burimet statistikore
 - 1.1.1. NRV-të dhe CPS do të llogariten në bazë të të dhënave për aksidentet hekurudhore dhe pasojat përkatëse, të raportuara sipas Shtojcës H të Rregullores (KE) Nr 91/2003 dhe sipas dispozitave të Neneve 5, 18 dhe Shtojcës I të Direktivës 2004 / 49 / EC.
 - 1.1.2. Në kuadër të përcaktimit të grupit të parë të CPS, në rast të mospërputhjeve midis të dhënave që vijnë nga dy burimet e referuara në pikën 1.1.1, të dhënat e raportuara sipas Shtojcës H të Rregullores (KE) Nr. 91/2003 do të kenë përparësi.
 - 1.1.3. Të dhënave që do të përdoren për atribuimin e vlerave të NRV dhe CPS do të përfshijnë katër vitet më të fundit.
 - 1.2. Njësitë matëse për NVR-të
 - 1.2.1. Njësitë matëse për NRV do të shprehen në përputhje me përkufizimin matematikor të rrezikut. Pasojat e aksidenteve që do të merren parasysh për secilën nga kategoritë e rrezikut janë FWSI-të.
 - 1.2.2. Njësitë matëse që do të përdoren për përcaktimin e numrit të NRV-ve për secilën nga kategoritë e rrezikut janë të përcaktuara në Shtojcën 1 dhe rezultojnë nga zbatimi i parimeve dhe përkufizimeve të përmendura në pikën 1.2.1 dhe kur është e rëndësishme, pika 1.2.3. Njësitë matëse përfshijnë bazat e shkallëzuar të listuara në Shtojcën 1, për normalizimin e NRV-ve.
 - 1.2.3. Për secilën nga kategoritë e rrezikut "udhëtarët" dhe "përdoruesit e kalimit në nivel" do të vendosen dy NRV të ndryshme, të shprehura me dy njësi matëse të ndryshme të referuara në Shtojcën 1. Për qëllime të vlerësimit të arritjeve të referuara në kapitullin 3, me të paktën një prej këtyre NRV do të konsiderohen të mjaftueshme.
 - 1.3. Njësitë matëse për CPS
 - 1.3.1. Njësitë matëse që do të përdoren për përcaktimin e sasisë së CPS për secilën nga kategoritë e rrezikut duhet të jenë të njëjta me ato të përshkruara për NRV në seksionin 1.2.
2. **Metodologjia për llogaritjen e NRV-ve dhe për matjen e CPS**
 - 2.1. Metodologjia për llogaritjen e NRV-ve
 - 2.1.1. Për secilin Shtet dhe për secilën nga kategoritë e rrezikut, NRV-ja llogaritet duke zbatuar në mënyrë sekuenciale procesin e mëposhtëm:
 - (a) llogaritjen e vlerave të kthyer nga njësitë korresponduese të matjes të renditura në Shtojcën 1, duke marrë parasysh të dhënat dhe dispozitat e referuara në nenin 1.1;

(b) analizën e rezultateve të procesit të përshkruar në pikën (a), për të kontrolluar praninë dhe përsëritjen e vlerave zero për FWSI-ve në performancat e mbikeqyrura të sigurisë për vitet në fjalë;

(c) nëse vlerat zero të referuara në pikën (b) nuk janë më shumë se dy, llogaritja bëhet nga mesatarja e ponderuar e vlerave të përmendura në pikën (a), siç përshkruhet në seksionin 2.3, dhe vlera e kthyer marrë si NRV;

(d) nëse vlerat zero të referuara në pikën (b) janë më shumë se dy, Agjencia do t'i atribuojë NRV-së një vlerë diskrete që do të identifikohet duke u konsultuar me Shtetin në fjalë.

2.2. Metodologjia për matjen e CPS nga NRV-të

2.2.1. Për secilën nga kategoritë e rrezikut, pasi që NRV të jetë llogaritur për secilin Shtet veq e veq sipas procedurës së përcaktuar në nenin 2.1, CPS përkatëse i caktohet një vlerë e barabartë me më të ulëtat nga:

(a) vlera e NRV e cila është më e larta midis Shteteve Anëtare;

(b) vlera e barabartë me 10 herë vlerën mesatare Evropiane të rrezikut për të cilin referohet NRV-ja.

2.2.2. Mesatarja Evropiane e cekur në pikën 2.2.1 (b) llogaritet duke grumbulluar të dhënat përkatëse për të gjitha Shtetet Anëtare dhe duke përdorur njësitë korresponduese të matjes të renditura në Shtojcën 1, si dhe mesataren e matur të përshkruar në seksionin 2.3.

2.3. Procesi i mesatares së matur për llogaritjen e NRV-së

2.3.1. Për çdo Shtet dhe për secilën nga kategoritë e rrezikut në të cilat mund të zbatohet mesatarja e matur sipas pikës 2.1.1 (c), hapat e mëposhtëm do të aplikohen për llogaritjen, gjatë vitit Y (ku si shembull $Y = 2009$ dhe 2011) NRV Y:

a) llogaritja e mbikeqyrjeve vjetore OBS_i (është viti i mbikëqyrur) i marrurë nga njësitë korresponduese të matjes të renditura në Shtojcën 1, pasi sigurojnë si të dhëna të dhënat për vitet më të fundit të raportuara siç përmenden në pikën 2.1 .1 (a) [fillimisht $n = 4$; prej 2011 e tutje $n = 6$];

b) llogaritja e mesatares aritmetike n-viti (AV) e mbikëqyrjeve vjetore OBS_i ;

c) llogaritja e vlerës absolute të diferencës $ABSDIFF_i$ ndërmjet çdo vrojtimi vjetor OBS_i dhe AV. Nëse $ABSDIFF_i < 0,01 * AV$, tek $ABSDIFF_i$ i jepet një vlerë konstante e barabartë me $0,01 * AV$;

- d) llogaritjen e peshës (W_i) për çdo vit të vetëm, duke u marrë inversi (e kundërta) i ABSDIFF_i;
- e) llogaritja e NRV_Y në formën e mesatares së matur, bëhet si më poshtë:

$$NRV_Y = \frac{\sum_{i=x}^N W_i \times OBS_i}{\sum_{i=x}^N W_i}$$

Ku (i) është numer natyral dhe

$$\left\{ \begin{array}{l} \text{nëse } Y = 2009: x = Y - 5; N = Y - 2 \\ \text{nëse } Y = 2011: x = Y - 7; N = Y - 2 \end{array} \right.$$

3. Modeli i kornizës për vlerësimin e arritjes së NVR-ve dhe CPS

3.1. Metodologjia për vlerësimin e arritjes së NVR-ve dhe CPS

3.1.1. Parimet e mëposhtme duhet të aplikohen për vlerësimin e arritjes së NVR-ve dhe CPS:

- a) për çdo shtet dhe për secilën nga kategoritë e rrezikut NRV-ja përkatëse e të cilëve është e barabartë ose më e ulët se CPS, arritja e NRV-ve do të nënkuptojë automatikisht arritjen e CPS. Vlerësimi i arritjes së NRV-ve do të kryhet sipas procedurës së përshkruar në seksionin 3.2 dhe NRV do të përfaqësojë nivelin maksimal të tolerueshëm të rrezikut ndaj të cilit ai i referohet, pa paragjykuar dispozitat mbi nivelin e tolerancës të përcaktuar në pikën 3.2.3;
- b) për çdo shtet dhe për secilën nga kategoritë e rrezikut, NRV-ja përkatëse e të cilëve është më e lartë se CPS, atëherë CPS do të përfaqësojnë nivelin maksimal të tolerueshëm të rrezikut të cilit i referohet. Vlerësimi i arritjes së CPS do të bëhet në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga vlerësimi i ndikimit, si dhe kur është e zbatueshme, afatet kohore për zbatimin gradual të CPS, sipas Nenit 7 (3) të Direktivës 2004/49 / EC.

3.1.2. Për secilin Shtet dhe për secilën nga kategoritë e rrezikut, vlerësimi i arritjes së NRV-ve dhe CPS do të bëhet çdo vit nga Agjencia, duke marrë si referencë raportimet (të dhënat) për katër vitet e fundit.

3.1.3. Jo më vonë se 31 mars të çdo viti, Agjencia i raporton Komisionit për rezultatet e përgjithshme të vlerësimit të arritjes së NVR-ve dhe CPS.

3.1.4. Duke marrë parasysh dispozitat e përcaktuara në pikën 1.1.3, nga viti 2012 e tutje, vlerësimi i arritjes së NVR-ve dhe CPS do të bëhet çdo vit nga Agjencia duke marrë parasysh raportimet e pesë viteve të fundit.

3.1.5. Rezultati i vlerësimit të arritjeve të cekura në pikën 3.1.1 duhet të klasifikohet si më poshtë:

- a) performanca e pranueshme e sigurisë;
- b) përkeqësimi i mundshëm i performancës së sigurisë;
- c) përkeqësimi i besueshëm i performancës së sigurisë.

3.2. Përshkrimi hap pas hapi i procedurës së cekur në pikën 3.1.1 (a)

3.2.1. Procedura për vlerësimin e arritjes së NRV-ve përbëhet nga katër hapa të ndryshëm siç përshkruhet në pikat e mëposhtme. Diagrami i përgjithshëm i vendimit për procesin dhe procedurën tregohet në Shtojcën 2, ku shigjetat pozitive dhe negative i përgjigjen rezultateve si "kaluese" dhe si "dështim". Kjo rrjedh si rezultat i hapave të ndryshëm të vlerësimit.

3.2.2. Hapi i parë i vlerësimit duhet të verifikojë nëse performanca e mbikëqyrur e sigurisë është në përputhje ose jo me NRV-në. Performanca e mbikëqyrur e sigurisë duhet të matet duke përdorur njësitë matëse të listuara në Shtojcën 1 dhe të dhënat e cekura në nenin 1.1, me seri kohore që do të përfshijë vitet e fundit të mbikëqyrjeve të përcaktuara në seksionin 3.1. Performanca e mbikëqyrur e sigurisë duhet të shprehet në terma të:

- a) performancën e sigurisë të mbikëqyrur vetëm në vitin e fundit të raportuar;
- b) mesatarja e matur lëvizëse (MML), siç përcaktohet në pjesën 3.3.

Vlerat e kthyera nga aplikimi i pikave (a) dhe (b) do të krahasohen me NRV dhe nëse njëra nga këto vlera nuk tejkalon NRV, performanca e sigurisë konsiderohet e pranueshme. Nëse nuk është kështu, procedura do të vazhdojë me hapin e dytë të vlerësimit.

3.2.3. Hapi i dytë i vlerësimit duhet të marrë parasysh performancën e sigurisë si të pranueshme nëse MML nuk tejkalon NRV me tepër se 20%. Nëse ky kusht nuk është i plotësuar, Agjencia do t'i kërkojë autoritetit të sigurisë të Shtetit Anëtar që të ofrojë specifikat e aksidentit me pasojat me të medha (në aspektin e FWSI) në vitet e fundit të mbikëqyrjes siç ceket në pjesën 3.1, duke përjashtuar vitet e përdorura për të vendosur ne përdorim NRV.

Nëse një aksident është më i rëndë, sa i përket pasojave, sesa aksidenti më i rëndë i përfshirë në të dhënat e përdorura për vendosjen ne përdorim te NRV, atëherë do të përjashtohet nga statistikat. MML pastaj rillogaritet për të kontrolluar nëse kjo e dhënë është brenda intervalit të lartpërmendur të tolerancës. Nëse është kështu, performanca e sigurisë konsiderohet e pranueshme. Nëse nuk është kështu atëherë procedura do të vazhdojë me hapin e tretë të vlerësimit.

3.2.4. Hapi i tretë i vlerësimit duhet të verifikojë nëse është hera e parë që në 3 vitet e fundit hapi i dytë i vlerësimit nuk ka kthyer dëshmi për performancën e pranueshme të

sigurisë. Nëse është kështu, rezultati i hapit të tretë të vlerësimit do të klasifikohet si "i miratuar". Procedura do të vazhdojë me hapin e katërt, pavarësisht nga rezultati i hapit të tretë.

- 3.2.5. Hapi i katërt i vlerësimit duhet të verifikojë nëse numri i aksidenteve të rëndësishme për tren-km, në vitet e mëparshme ka mbetur i njëjtë (ose është zvogëluar). Kriteret për këtë vlerësim do të jenë nëse ka pasur një rritje statistikore domethënëse në numrin e aksidenteve të rëndësishme të rëndësishme për tren-km. Kjo do të vlerësohet duke përdorur një tolerancë të sipërme e cila do të përcaktojë ndryshueshmërinë e pranueshme bazuar në numrin e aksidenteve që kanë ndodhur në Shtetet e ndryshme Anëtare.

Nëse numri i aksidenteve të rënda për tren-km nuk tejkalon kufirin e lartpërmendur të tolerancës, supozohet se nuk ka pasur rritje statistikore të konsiderueshme dhe rezultati i këtij hapi vlerësues do të klasifikohet si "i miratuar".

Varësisht nga kategoria e rrezikut të cilës i referohen NRV të ndryshme për vlerësimin e arritjeve, aksidentet e rënda që do të merren parasysh për kryerjen e këtij hapi të vlerësimit janë si më poshtë:

- a) rreziqet për udhëtarë: të gjitha aksidentet relevante (të rëndësishme);
- b) rreziqet për personelin ose punonjësit, duke përfshirë stafin e kontraktorëve: të gjitha aksidentet relevante të rëndësishme;
- c) rreziqet për përdoruesit e kalimit në nivel: të gjitha aksidentet relevante të rëndësishme të përfshira në kategorinë 'aksidente që përfshijnë kalimet në nivel';
- d) rreziku për personat e paautorizuar në mjediset hekurudhore: të gjitha aksidentet relevante të rëndësishme të përfshira në kategorinë 'aksidente ndaj personave të shkaktuara nga mjetet lëvizëse në lëvizje';
- e) rreziku ndaj të tjerëve: të gjitha aksidentet relevante të rëndësishme;
- f) rreziku për shoqërinë si tërësi: të gjitha aksidentet e rëndësishme.

3.3. Zhvendosja e procesit mesatar të matur për vlerësimin vjetor të arritjes së NVR-ve

3.3.1. Për secilin Shtet Anëtar dhe për secilën nga kategoritë e rrezikut në të cilat zbatohet Mesatarja e Matur Lëvizëse (MMA), për çdo vit Y (duke filluar nga Y = 2010 e tutje), hapat e vlerësimit të përshkruara në pjesën 3.2, për llogaritjen e MMA Y do të aplikohen etapat e mëposhtme:

- a) llogaritja e vrojtimit vjetor OBS_i i kthyer nga indikatorët përkatës të listuar në Shtojcën 1, pasi që sigurohen si të dhëna të disponueshme nga burimet e referuara në nenin 1.1 për vitet përkatëse (indeksi i merr vlerat siç përcaktohet në formulën e mëposhtme);
- b) llogaritja e mesatares aritmetike n-vjeçare (AV) të mbikëqyrjeve vjetore OBS_i [fillimisht n = 4; nga 2012 e tutje n = 5];

- c) llogaritja e vlerës absolute të diferencës $ABS\text{DIFF}_i$, ndërmjet çdo mbikëqyrjeje vjetore OBS i dhe AV. Nëse $ABS\text{DIFF}_i < 0,01 * AV$, tek $ABS\text{DIFF}_i$ i atribuohet një vlerë konstante e barabartë me $0,01 * AV$;
- d) llogaritjen e peshës së aksidentit W_i , bëhet duke marrë të kundërtën e $ABS\text{DIFF}_i$;
- e) llogaritja e MML_Y bëhet si me poshtë:

$$MML_Y = \frac{\sum_{i=x}^N W_i \times OBS_i}{\sum_{i=x}^N W_i}$$

Ku (i) është numer natyral dhe

$$\begin{cases} \text{nëse } Y = 2010: x = Y - 5; N = Y - 2 \\ \text{nëse } Y = 2012: x = Y - 6; N = Y - 2 \end{cases}$$

SHTOJCË 1

Njësitë matëse për NRV dhe CPS

Kategoria e Rrezikut	Njësitë Matëse	Bazat e shkallëzimit
1. Rreziku për Udhëtarë	Numri i viktimave të udhëtarëve (FWSI) dhe dëmtimeve të rënda në vit që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / Numri i tren-km të udhëtarëve në vit	Tren-km të udhëtarëve në vit
	Numri i viktimave të udhëtarëve (FWSI) në vit që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / Numri i kilometrave (km) të udhëtarëve në vit	Kilometra (km) të udhëtarëve në vit
2. Rreziku për punonjësit	Numri i punonjësve të vdekur dhe dëmtimeve të rënda (FWSI) në vit, që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / Numri i tren-km në vit	Tren-km në vit
3. Rreziku për përdoruesit e kalimit në nivel	Numri i përdoruesve të kalimit në nivel (FWSI) në vit që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / Numri i tren-km në vit	Tren-km në vit
	Numri i përdoruesve të kalimit në nivel (FWSI) në vit që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / [(Numri i tren-km në vit × Numri i kalimeve në nivel) / Binarë-km]	(Numri i tren-km në vit × Numri i kalimeve në nivel) / Binarë-km
4. Rreziku ndaj të tjerëve	Numri vjetor i FWSI për personat që i përkasin kategorisë të 'tjerët' rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / Numri i tren-km në vit	Tren-km në vit
5. Rreziku ndaj personave të paautorizuar në mjediset hekurudhore	Numri i FWSI ndaj personave të paautorizuar në mjediset hekurudhore në vit që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / numri i tren-km në vit	Tren-km në vit
6. Rrezik për të gjithë shoqërinë	Numri total i FWSI-ve në vit që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / Numri i tren-km në vit	Tren-km në vit

SHTOJCË 2

Diagrami i vendimit për procedurën e përmendur në pikën 3.1.1 (a) të Shtojcës

